



Prishtinë, 07 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1424_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Neni 47 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën Nr. 15/2017 për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr.05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSH);

në seancën e mbajtur më 7 tetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR) për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU/KESCO), që do të mbliidhen nga KESCO/FSHU përmes tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, për vitin relevant tarifor 2021.**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal që mbulohen nga tarifat me pakicë të energjisë elektrike për vitin relevant tarifor 2021 do të jenë 290,139,654 Euro.**
- III. Furnizuesi i Shërbimit Universal sipas këtij Vendimi udhëzohet t'i përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE propozimin për aprovim të tarifave të rregulluara me pakicë sipas këtij vendimi.**
- IV. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU-në do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës Nr. 15/2017 për Të Hyrat e FSHU-së, të nxjerr nga ZRRE**



- V. Tarifat e propozuara nga i licencuari duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullën Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (KESCO) nga 1 tetor 2021 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 11 dhjetor 2020 ka iniciuar azhurnimet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale(MAR) për FSHU për vitin relevant tarifor 2021.
- ZRRE me rastin e vendosjes për të Hyrat e Lejuara Maksimale(MAR) që do të mbulohen nga FSHU ka marrë parasysh dokumentet që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
 - Aplikacionin e Furnizuesit me Shërbim Universal KESCO SH.A (FSHU) për kërkesën e të Hyrave të Lejuara Maksimale, të dorëzuar më datën 8 mars 2021;
 - Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Shpërndarjes – KEDS SH.A (OSSH) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 8 mars 2021 në ZRRE;
 - Aplikacionin e Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut – KOSTT SH.A (OST/OT) për të Hyrat e Lejuara Maksimale, të dorëzuar me datën 27 janar 2021 në ZRRE;
 - Raport Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal (Prill 2021-mars 2022), i publikuar më datë 24 gusht 2021;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
 - Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 24 gusht 2021;
 - Komentet e Furnizuesit me Shërbim Universal KESCO Sh.A. (FSHU) ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KESCO (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 7 shtator 2021.
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU, Përgjigjet ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar më 8 tetor 2021;
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar 8 tetor 2021; dhe
 - Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (Viti relevant tarifor 2021), i publikuar 8 tetor 2021.
 - Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale të KOSTT-it Nr. V_1422_2021 që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut KOST SH.A (KOSTT);



➤ Vendimin Hyrat e Lejuara Maksimale të KEDS-it Nr. V_1423_2021 për të që do të mbulohe nga Operatori i licencuar i Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A (OSSH).

- Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Gashi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.